

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5574  
E mërkurë, 12 shtator 2018  
çmimi 0.40 €

Hoxhaj: Në fazën finale të dialogut, mbështetja e ShBA-së është e rëndësishme



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

**I KTHYER NË VENDIN E KRIMIT** F. 11



Nga Bedri ISLAMI

**HARADINAJ: LOJA ME KUFIJ, EKSPERIMENT I RREZIKSHËM** F. 3

**BYTYQI: DEPOLITIZIMI I SHKOLLAVE, SFIDË QË DUHET TË TEJKALOHE** F. 5

## EKONOMI



**PUNËTORËT E KEDS-it KËRKOJNË RITJE TË PAGAVE** F. 9

**OECD-u SUGJERON TË PUNOHET MË SHUMË PËR RITJEN EKONOMIKE NË KOSOVË** F. 8

## SPORT



**KOSOVA KËRKON NJË TJETËR FITORE NDAJ MAQEDONISË** F. 12

**BALLKANI NDALI PRISHTINËN, SOT DERBI DRITA - LLAPI** F. 12



FLET PËR "EPOKËN E RE", AHMET ISUFI

## Opozita e çakorduar nuk paraqet rrezik për Qeverinë Haradinaj

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe shefi i grupit parlamentar i kësaj partie, Ahmet Isufi, e ka quajtur qeveri të suksesshme Qeverinë Haradinaj meqë, sipas tij, ka marrë vendime të rëndësishme gjatë këtij viti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", ai ka thënë se ky kabinet qeveritar ka krijuar disiplinë dhe angazhim praktik në të gjitha sferat e qeverisjes. Të arritura të saj Isufi ka konsideruar vendimin për Termocentralin "Kosova e Re", Ligjin për Prishtinën, Projektligjin për Pagat dhe Projektligjin

për reformimin e administratës publike. Ai ka thënë se nëse Qeveria Haradinaj vazhdon me këtë ritëm të punës, do ta çojë deri në fund mandatin qeverisës. Sipas Isufit, një opozitë e çakorduar çfarë është aktualisht nuk paraqet rrezik për Qeverinë Haradinaj

## Kosova dhe Amerika, gjithmonë bashkë, në ditë pikëllimi dhe gëzimi



Sulmet terroriste të kryera më 11 shtator 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin kundër vlerave

perëndimore të civilizimit dhe tërë botës demokratike, kanë vlerësuar liderët shtetërorë të Kosovës



**Veseli dhe O'Connell nënshkruajnë sërish marrëveshje për rekrutimin e pozitive të larta** F. 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Mali i Zi e përkrah dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologu i tij malazias, Millo Gjukanoviq, të martën janë takuar në Podgoricë dhe kanë biseduar për zhvillimet rajonale. Përmes një statusi në faqen e tyre, të dy presidentët kanë njoftuar për këtë takim.

"Sot pata kënaqësinë të takohem me presidentin e Malit të Zi, Millo Gjukanoviq, në Podgoricë. Biseduam për

raportet bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, për thellimin e bashkëpunimit në të gjitha sferat institucionale dhe shoqërore. Diskutuam edhe për zhvillimet rajonale dhe për përpjekjet për forcimin e paqes dhe stabilitetit, si dhe për të ardhmen euroatlantike të rajonit si tërësi. Ishte inkurajuese përkrahja e presidentit Gjukanoviq për përpjekjet e shtetit të Kosovës dhe Serbisë

për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërshtetërore, me lehtësimin e Bashkimit Evropian, që përmes negociatave dhe në mënyrë paqësore të arrihet një marrëveshje e pranueshme për të dyja palët. Marrëveshja ndërshtetërore Kosovë - Serbi do të jetë një kontribut shtesë për paqen dhe stabilitetin në Ballkan, si dhe për perspektivën e përbashkët evropiane", ka shkruar Thaçi.



## Referendumi përcakton izolimin ose integrimin e Maqedonisë

Për t'i dhënë mbështetje referendumit gjatë kësaj jave në Shkup kanë qëndruar sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, kancelari austriak Sebastian Kurz, të shtunën ishte edhe kancelarja gjermane Angela Merkel

SHKUP, 11 SHTATOR - Maqedonia nuk ka alternativë tjetër për t'u bërë pjesë e strukturave euroatlantike pa realizuar referendum të suksesshëm, përkatësisht duhet t'i thotë "po" marrëveshjes Maqedoni - Greqi që parasheh zgjidhjen e kontestit të emrit. Kjo ishte porosia e përfaqësuesve të lartë të NATO-s dhe BE-së, drejtuar më shumë presidentit të Maqedonisë dhe partisë maqedonase në opozitë VMRO DMNE, që janë kundër marrëveshjes në fjalë, vlerëson Alajdin Demiri, ish-diplomat. Në mbështetje të referendumit gjatë kësaj jave në Shkup kanë qëndruar sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, kancelari austriak Sebastian Kurz, të shtunën edhe kancelarja gjermane Angela Merkel.

Demiri thotë se porositë e zyrtarëve të lartë të NATO-s dhe të BE-së janë në funksion të ngritjes së vetëdijes së politikanëve të vendit, por edhe vetë qytetarëve para referendumit në mënyrë që ai të dalë i suksesshëm. "Natyrishë se ekzistojnë

strukturat të cilat janë anti-NATO dhe anti-Bashkimit Evropian, mirëpo ata në mënyrë perfide luajnë rolin formal, kinse janë pro strukturave euroatlantike, por realisht ata punojnë kundër. Kështu është pozita e presidentit të shtetit i cili në mënyrë permanente bën pengesa këtu. Është edhe opozita maqedonase që në mënyrë permanente bën ngatërresa dhe porositë e faktorit ndërkombëtar janë për ata", thotë Demiri.

Por, Risto Nikovski, ish-diplomat, i cili ka qenë këshilltar në kabinetin e presidentit të Maqedonisë, konsideron se faktori ndërkombëtar me pa të drejtë i bën presion Maqedonisë ta ndryshojë, siç thotë, emrin historik të shtetit. Nikovski thotë se porositë që vijnë nga zyrtarët e lartë të NATO-s dhe BE-së janë në vazhden e bllokadës kërcënuese që tanimë e kanë thënë disa herë "të zgjidhet çështja e emrit, pastaj do të hapen dyert për anëtarësim". "Ky ultimatum paraqet



nënçmim për shtetin, de fakto vendosen kushte të papërshtatshme dhe mendoj se këto kushtëzime janë turpëruese si për NATO-n, po ashtu edhe për Bashkimin Evropian", tha ai. "Përsëritja e flluskave të tilla vetëm se dëshmon se ata sillen në mënyrë joligjore ndaj Maqedonisë si shtet sepse në asnjë dokument të tyre nuk shkruan se një shtet duhet të plotësojë kushte të nënçmuese që të bëhet anëtar i këtyre strukturave", thekson Risto Nikovski, ish-ambasador. Sipas tij, sugjerimet e faktorit ndërkombëtar lidhur me referendumin duhet me çdo kusht

të shpërfillen sepse nuk janë në interes të Maqedonisë si shtet. "Ata synojnë që me të gjitha forcat ta kalojnë referendumin, përkatësisht ta legjitimojnë kapitullimin që e ka nënshkruar qeveria jonë me marrëveshjen me Greqinë për emrin. Mënyra e vetme që të shpëtojë populli maqedonas është të bojkotohet referendumi", thotë Nikovski.

Por, ish-diplomati shqiptar Alajdin Demiri vlerëson se ardhja, veçanërisht e kancelares Merkel në Maqedoni, duke dhënë porosi të qarta për referendumin, paraqet një vizitë historike, veçanërisht për

shkak të pozitës së saj të lartë në Evropë, po ashtu edhe në botë.

Demiri thekson se mesazhi i saj ishte se Maqedonia si shtet përmes realizmit të referendumit të suksesshëm të orientohet nga integrimet euroatlantike duke u shpëputur tërësisht nga influenca ruse që në masë të caktuar është e pranishme në vend. "Porosia është shumë e qartë që Maqedonia të shpëtojë dhe të orientohet kah Bashkimi Evropian dhe kah NATO, që të mos marrë ndonjë kah tjetër. Si alternativë këtu mendohet për Rusinë", thotë Demiri.

## Tsipras: Vazhdojmë dialogun me Shqipërinë

STRASBURG, 11 SHTATOR - Ne po zhbllokojmë integrimin evropian të fqinjëve tanë ballkanikë, me Marrëveshjen e Prespës, për fqinjin tonë verior, si edhe dialogun e vazhdueshëm me Shqipërinë, deklaroi të martën kryeministri grek Aleksis Tsipras në një seancë

plenare që po zhvillohet në Parlamentin Evropian në Strasburg. "Jemi të vendosur për të mos përsëritur gabimet që sollën krizën në Greqi", theksoi ai. "Do të vazhdojmë sakrificat ekonomike që Greqia të vazhdojë rrugën e arritjes së bilancit

financiar, ku pas tre viteve tani jemi një pozicion ndryshe", tha Tsipras. "Ky është një sukses i popullit grek, por edhe sukses i Europës që ka demonstruar me një frymë solidariteti dhe bashkëpunimi për të tejkaluar krizën", tha Tsipras.





Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

# Haradinaj: Loja me kufij, eksperiment i rrezikshëm



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka vlerësuar edhe një herë të rrezikshme idenë për ndryshimin e kufijve të Kosovës. Ai ka deklaruar të martën se kjo ide është një eksperiment i rrezikshëm për shtetin e Kosovës dhe për rajonin. Sipas Haradinajt, sa herë që janë hapur kufijtë kanë sjellë tragjedi në rajon

opozita do t'i japë përkrahje këtij ekipi", është shprehur Haradinaj.

## Qeveria ka miratuar raportin njëvjeçar të punës

Në mbledhjen e së martës kabineti qeveritar ka miratuar raportin e punës njëvjeçarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, shtator 2017 - shtator 2018. Kryeministri Haradinaj ka thënë se Qeveria e Kosovës në këtë periudhë kishte prioritet zhvillimin ekonomik, sigurinë dhe sundimin e ligjit. "Shpreh falënderimin tim për të gjithë në Qeveri, për angazhimin dhe njëkohësisht dëshiroj t'ju ftoj që në planin vjetor për vitin 2018 të jemi ambiciozë, të jemi të qartë, të mund t'i zbatojmë ato politika që i nxjerrim ne, por edhe politika që burojnë nga vendimet e Parlamentit dhe institucionet e vendit", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Brenda këtij viti qeverisë janë nxjerrë 756 vendime, prej të cilave nga fusha e ekonomisë janë 130, 102 projektligje, 36 akte nënligjore, 118 akte nënligjore të nxjerra nga ministratë në kuadër të fushëveprimit të tyre, po ashtu edhe 30 koncept dokumente.

Ndër të tjera, kabineti qeveritar ka aprovuar vendimin për rivarrimin e eshtreve të heroit Ilir Konushëci nga varrezat e Tiranës në Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë. Riadthesimi do të kryhet në nëntor të këtij viti që përkon me festën e flamurit, në pajtim edhe me vullnetin e familjes.

Qeveria e Kosovës i ka propozuar Kuvendit të Kosovës që Osman Vishaj të jetë kandidat për kryetar të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Kabineti qeveritar ka miratuar vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 255 613 eurosh për shlyerjen e borxheve të mbetura nga manifestimet për shënimin e dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Gjithashtu, kabineti qeveritar ka vendosur që pas konsultimeve të nevojshme me Ministrinë e Financave rreth mundësive buxhetore, të ndahen mjete financiare për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në Komunën e Mamushës.

**EPOKA  
ERE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 11 SHTATOR** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka ripërsëritur qëndrimin e vet kundër idesë për ndryshimin e kufirit të Kosovës. Ai ka thënë se ideja për ndryshimin e kufijve është një eksperiment i rrezikshëm për vendin. "Është eksperiment i rrezikshëm loja me kufi e terri-tore. Jam kundër këtyre eksperimenteve dhe i lus të gjithë të kenë kujdes", ka deklaruar Haradinaj në një konferencë për media pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës. Ai ka bërë thirrje që të ndalet kjo retorikë politike ngaqë, sipas tij, Kosova nuk e ka luksin të lëshohet në temën e ndryshimit të kufirit.

Kreu i Qeverisë është shprehur i rezervuar të flasë për kërkesën e përfaqësuesve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, që Kuvendi i Kosovës të miratojë një

rezolutë si mbështetje politike që këto komuna të Serbisë t'i bashkohen Kosovës. "Ne do ta mbajmë vëmendjen gjithmonë për ta përkrahur Preshevën, kurse sa iu përket këtyre temave, Kushtetuta e vendit na obligon për territor dhe kufi. Unë mbaj pozicion të rezervuar për gjëra të tjera. I përmbahem Kushtetutës së vendit. Është eksperiment i rrezikshëm loja me kufijtë", ka thënë ai, duke shtuar se hapja e kufijve çdoherë ka sjellë tragjedi në rajon. "Të gjithë jemi të vetëdijshëm se e rrezikshme është loja me kufi në Ballkan. E dimë këtë nga e kaluara se, sa herë janë hapur këto tema, nuk dihet ku janë mbyllur dhe në të mirën e kujt", ka deklaruar Haradinaj.

Kryeministri edhe një herë ka ftuar opozitën të përfshihet në ekipin negociator në mënyrë që ky ekip ta përfaqësojë Kosovën në fazën finale të bisedimeve me Serbinë. "Shpresojmë që edhe

## Qeveria merr vendim për vendosjen e përherëshme të një pllake përkujtimore për 11 shtatorin 2001

Në përvjetorin e sulmit terrorist në Nju Jork dhe në shenjë nderimi për viktimat që humbën jetën nga sulmi në Qendrën Botërore të Tregtisë në Nju Jork, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka miratuar vendimin për vendosjen e pllakës përkujtimore në hapësirën e ndërtesës së Qeverisë. Kryeministri Haradinaj ka propozuar para kabinetit qeveritar miratimin e propozimvendimit për vendosjen e këtij memoriali të përherëshëm, që përkujtimi të bëhet tradicional, në shenjë nderimi për jetët e humbura në tragjedinë e 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky propozim mori miratimin e plotë. Kryeministri ka theksuar se roli që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kishin për përkrahjen e luftës për liri të Kosovës, na bëjnë të jemi gjithmonë solidarë me popullin dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

## Mustafa takon ambasadorin Delawie, flasin për temat aktuale

**PRISHTINË, 11 SHTATOR (ER)** - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka pritur të martën në takim përshëndetës ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Greg Delawie. Gjatë këtij takimi

Mustafa ka falënderuar ambasadorin Delawie për kontributin e madh të tij dhe për mbështetjen e pazëvendësueshme të Qeverisë dhe popullit amerikan për shtetndërtimin e Kosovës. Në këtë takim Mustafa e Delawie kanë biseduar edhe për

çështje të tjera aktuale me rëndësi për Kosovën dhe rolin e ShBA-së. Pjesë e këtij takimi kanë qenë edhe nënkryetarët e LDK-së, Lutfi Haziri dhe Agim Veliu, sekretari i përgjithshëm Ismet Beqiri dhe kryetarja e Forumit të Gruas së kësaj partie, Lirije Kajtazi.





Flet për "Epokën e re", Ahmet Isufi

# Opozita e çakorduar nuk paraqet rrezik për Qeverinë Haradinaj

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe shefi i grupit parlamentar i kësaj partie, Ahmet Isufi, e ka quajtur qeveri të suksesshme Qeverinë Haradinaj meqë, sipas tij, ka marrë vendime të rëndësishme gjatë këtij viti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky kabinet qeveritar ka krijuar disiplinë dhe angazhim praktik në të gjitha sferat e qeverisjes. Prej të arriturave të saj, Isufi ka konsideruar vendimin për Termocentralin "Kosova e Re", Ligjin për Prishtinën, Projektligjin për Pagat dhe Projektligjin për reformimin e administratës publike. Ai ka thënë se nëse Qeveria Haradinaj vazhdon me këtë ritëm të punës do ta çojë deri në fund mandatin qeverisës. Sipas Isufit, një opozitë e çakorduar çfarë është aktualisht nuk paraqet rrezik për Qeverinë Haradinaj

**EPOKA E RE** **Shqipe HETEMI**

**PRISHTINË, 11 SHTATOR** - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka thënë të martën se Qeveria Haradinaj gjatë punës së vet njëvjeçare ka treguar kulturë ndryshe të qeverisjes nga ato paraprake. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se kjo qeveri është treguar e suksesshme në bazë të hapave që ka ndërmarrë. "Është një qeverisje krejt ndryshe në krahasim me të gjitha qeveritë e tjera. Kemi vendime konkrete të cilat kanë favorizuar Kosovën në shumë aspekte. Kjo Qeveri ka zgjidhur çështjen e demarkacionit me Malin e Zi si dhe ka përfunduar procesin e liberalizimit të vizave. Prandaj konsiderojmë se është qeveri shumë e suksesshme duke pasur parasysh hapat që i ka ndërmarrë në të gjitha aspektet", ka deklaruar Isufi. Ai ka thënë se ky kabinet qeveritar ka krijuar disiplinë dhe angazhim praktik në të gjitha sferat e qeverisjes.

Prej të arriturave të saj, Isufi ka konsideruar vendimin për Termocentralin "Kosova e Re", Ligjin për Prishtinën, Projektligjin për Pagat dhe Projektligjin për reformimin e administratës publike. "Ka hapa konkretë të cilët kanë ndodhur, siç është vendimi për Termocentralin 'Kosova e Re', që është një investim prej 1 miliard e 300 milionë eurosh. Pastaj vendimet e tjera që kanë pasur të bëjnë me ligjet të cilat nuk janë aprovuar për 18 vjet me radhë, siç ka qenë Ligji për Prishtinën. Po ashtu, është zgjidhur çështja e Pallatit të Rinisë. I është dhënë zgjidhje çështjes së Hades dhe Shipitullës meqë Kosova rrezikonte të shkojë në krizë energjetike. Ka pasur vendime të cilat kanë favorizuar qytetarët e Kosovës. Janë ndërmarrë hapa jashtëzakonisht të mirë për këtë

periudhë të shkurtër", është shprehur ai. Sipas Isufit, nëse Qeveria Haradinaj vazhdon me këtë ritëm të punës, do ta çojë deri në fund mandatin qeverisës. Në këtë kontekst, ai ka thënë se një opozitë e çakorduar çfarë është aktualisht nuk paraqet rrezik për Qeverinë Haradinaj. "Opozita nuk është në pozitë të mirë sepse ka divergjencë dhe ka s'përputhje në mes të kërkesave të tyre dhe qëllimit për ta ndryshuar gjendjen. Prandaj një opozitë e çakorduar çfarë është tani nuk paraqet rrezik për Qeverinë Haradinaj", ka theksuar Isufi.

**"Epoka e re":** Z. Isufi, është bërë një vit prej se Qeveria Haradinaj ka ardhur në krye të vendit. Cili është bilanci për këta 12 muaj të qeverisjes?

**Isufi:** Është një qeverisje krejt ndryshe në krahasim me të gjitha qeveritë e tjera. Kemi vendime konkrete të cilat kanë favorizuar Kosovën në shumë aspekte. Kjo Qeveri ka zgjidhur çështjen e demarkacionit me Malin e Zi si dhe ka përfunduar procesin e liberalizimit të vizave. Prandaj, konsiderojmë se është Qeveri shumë e suksesshme duke pasur parasysh hapat që i ka ndërmarrë në të gjitha aspektet.

**"Epoka e re":** Ju po e quani Qeveri të suksesshme, por në kohën për të cilën po flasim nuk ka pasur krijim të vendeve të reja të punës, zhvillim ekonomik, rritje të numrit të njohjeve. E gjithë vëmendja, si duket, është përqendruar në dialogun me Serbinë. Sipas jush, cilat kanë qenë të arriturat dhe dështimet e Qeverisë gjatë këtij viti?

**Isufi:** Ka hapa konkretë të cilët kanë ndodhur, siç është vendimi për Termocentralin "Kosova e Re", që është një investim prej 1 miliard e 300 milionë eurosh. Pastaj vendimet e tjera që kanë pasur të bëjnë me ligjet të cilat

nuk janë aprovuar për 18 vjet me radhë, siç ka qenë Ligji për Prishtinën. Po ashtu është zgjidhur çështja e Pallatit të Rinisë. I është dhënë zgjidhje çështjes së Hades dhe Shipitullës meqë Kosova rrezikonte të shkojë në krizë energjetike. Ka pasur vendime të cilat kanë favorizuar qytetarët e Kosovës. Janë ndërmarrë hapa jashtëzakonisht të mirë për këtë periudhë të shkurtër.

**"Epoka e re":** Liderët e koalicionit qeverisës në vazhdimësi kanë thënë se kjo Qeveri do të jetë e vendimeve të mëdha, megjithatë për këtë periudhë nuk ka vendime të tilla, me përjashtim të zgjidhjes së çështjes së demarkacionit me Malin e Zi. Qytetarët mund të presin se këto vendime do të merren në periudhën e ardhshme qeverisëse?

**Isufi:** Janë marrë vendime të mëdha dhe disa prej tyre i përmenda më lart. Qeveria Haradinaj ka ngritur pagat në shumë sektorë, madje ka miratuar edhe Projektligjin për pagat i cili është proceduar në Kuvend dhe ky është një tregues për suksesin e kësaj qeverie. Njëkohësisht kemi të bëjmë edhe me angazhimet të cilat do të jenë në të ardhmen, sidomos në sektorin e ekonomisë dhe në sektorë të tjerë.

**"Epoka e re":** Disa prej vendimeve të cilat i ka marrë kjo Qeveri dhe që ju i përmendet nga opozita dhe shoqëria civile janë konsideruar si skandale, siç ka qenë vendimi për rritjen e pagës së kryeministrit dhe kabinetit qeveritar, vendimi për faljen e borxheve për ambalazhuesit e ujit, dhënia e 53 milionë euro "Bektel Enka" dhe të tjera. Po ashtu, Qeveria është kritikuar edhe për numrin e madh të ministrave dhe zëvendësministrave.

**Isufi:** Vendimet e Qeverisë nuk i pëlqejnë sidomos opozitës, megjithatë janë vendime që



ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Natyrisht se kur merren shumë vendime, ndonjë edhe mund të jetë jopopullor. Por, gjërat në total duhet të shikohen, dhe jo në mënyrë të njëanshme.

**"Epoka e re":** Cilat janë tri të arriturat kryesore të Qeverisë Haradinaj?

**Isufi:** Kjo Qeveri që nga dita e parë kur ka filluar punën ka krijuar disiplinë dhe angazhim më praktikë në të gjitha sferat sa i përket qeverisjes. E dyta është raporti i nivelit qendror me komunat të cilat janë vlerësuar dhe trajtuar njësoj, pavarësisht prej dallimeve politike të së kaluarës. Pastaj është Termocentrali "Kosova e Re" dhe Ligji për Prishtinën që ka pritur 18 vjet për aprovim.

**"Epoka e re":** Qeveria Haradinaj është në presionin e numrave duke pasur në Kuvend shumicën e thjeshtë prej 61 votave, por që shpeshherë ka munguar edhe kjo shumicë. Do të jetë i mundur funksionimi i kësaj qeveri deri në fund të mandatit me këta numra? **Isufi:** Është e vërtetë se çështja e numrave është delikate në këtë periudhë por, krahasuar me peri-

udhat e tjera, vërehet një dallim sepse ka pasur koalicione me mbi 80 vota, por nuk kanë qëndruar dhe janë shembur. Kurse Qeveria Haradinaj vetëm me punë e argumenton ekzistencën e vet. Nëse vazhdon të punojë me këtë ritëm, do ta përfundojë mandatin qeverisës sepse qytetarët janë të interesuar të ketë punë dhe të ketë motiv për ta shtyrë Kosovën përpara.

**"Epoka e re":** S'ka ndonjë rrezik nga opozita që ka paralajmëruar inicimin e një mocioni të mosbesimit ndaj kësaj Qeverie?

**Isufi:** Opozita nuk është në pozitë të mirë sepse ka divergjencë dhe ka s'përputhje në mes të kërkesave dhe qëllimit për të ndryshuar gjendjen. Prandaj një opozitë e çakorduar çfarë është tani nuk paraqet rrezik për Qeverinë Haradinaj.

**"Epoka e re":** Z. Isufi, do të kemi ndryshim të qasjes së Qeverisë për të bashkëpunuar me opozitën meqë përpara tyre është një numër i konsideruar i problemeve madhore që kërkojnë zgjidhje?

**Isufi:** Në vazhdimësi jemi në komunikim me opozitën, sidomos për çështjet kapitale të vendit, siç





## Bytyqi: Depolitizimi i shkollave, sfidë që duhet të tejkalohet

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka thënë se cilësia e cila është në sistemin e arsimit në Kosovë nuk siguron një të ardhme të zhvillimit të vendit. Pavarësisht prej kësaj, ai ka thënë se është duke u punuar në të gjitha fushat që të ketë ngritje të cilësisë në arsim.

Duke folur në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Bytyqi ka bërë me dije se në shumicën e shkollave ka një politizim ku, sipas tij, për ta hapur frymëmarrjen e lirë të sistemit arsimor patjetër duhet të bëhet depolitizimi i shkollave. "Nuk është gjendja çfarë do të kishim dëshirë të ishte në sistemin arsimor në Kosovë. Nuk është edhe ajo gjendje çfarë ne synojmë të jetë në sistemin arsimor. Këtë e kemi konstatuar që nga momenti kur e kemi marrë përgjegjësinë dhe vazhdimisht deri më tani e kemi bërë një analizë të përgjithshme për të kuptuar se ku jemi dhe çka tutje. Nuk është një cilësi e cila na siguron një të ardhme të sigurt të zhvillimit të vendit. Cilësia



në arsim është faktor kyç që ndikon në të gjitha sektorët e tjerë të zhvillimit të vendit. Shkaqet mund të jenë të ndryshme, pasojat mund të jenë të ndryshme. Tani është koha të merremi me eliminimin e këtyre pasojave, këtyre dobësive që ekzistojnë në sistemin arsimor. Për t'i eliminuar këto duhet një qasje reale e problemeve që

ekzistojnë. Së pari duhet të pajtohemi me gjendjen që e kemi në sistemin arsimor, pastaj mbi këtë gjendje të marrim hapa konkretë për ta ndryshuar sistemin arsimor, gjegjësisht ngritjen e standardit në nivel tjetër të cilësisë në arsim", ka thënë Bytyqi, duke shtuar se sfidë e Qeverisë mbetet depolitizimi i shkollave.

## Universiteti 'Kadri Zeka' në Gjilan ka hapur konkursin plotësues për studentët e rinj

GJILAN, 11 SHTATOR (ER) - Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan në vitin e parë të studimeve, në afatin e dytë të konkursit plotësues për vitin akademik 2018/2019, do t'i regjistrojë 666 studentë të rregullt në studime bachelor.

Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të paraparë si më sipër, universiteti do të regjistrojë deri në 2 për qind, përkatësisht deri në 22 studentë të rregullt që i takojnë familjes së ngushtë të dëshmorëve (anëtarë të familjes së ngushtë të dëshmorëve janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët). Studentët e kësaj kategorie do të shpërndahen në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.

Nga numri i përgjithshëm i përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, universiteti do të regjistrojë deri në 12 për qind, përkatësisht deri në 123 studentë të rregullt nga komuniteti joshumicë.

Kuota prej 12 përqindësh të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga



komuniteti joshumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT-i dhe Senati, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja.

Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen si në paragrafin 1 të pikës është deri 29 studentë. Në universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga Senati, mund të pranohen edhe kandidatët jashtë Kosovës, përkatësisht 13 studentë

të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.

Universiteti do t'i ketë në konsideratë në mënyrë të veçantë edhe kandidatët me nevoja të veçanta të cilët e kalojnë pragun e provimit pranues.

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve aplikimi online mund të bëhet prej datës 11. 9. 2018 deri më 19. 9. 2018 në orën 16:00.

Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në uebfaqen e universitetit. Provimi pranues do të mbahet më 21. 9. 2018.

është dialogu dhe liberalizimi i vizave, për të cilat duhet bashkëpunim më i madh. Për çështjet që kanë të bëjnë me interesat e shtetit të Kosovës pozita dhe opozita duhet të jenë bashkë sepse vetëm në mënyrë të tillë mund t'i arrijmë objektivat tona si Kosovë. Prandaj kërkojmë nga opozita të jetë më reflektuese dhe të heqë dorë nga interesat e ngushta partiake për shkak se shteti është në pyetje, sidomos kur bëhet fjalë për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

**"Epoka e re":** Cili do të jetë fokusi i kësaj Qeverie në 12 muajt e ardhshëm?

**Isufi:** Aktualisht është duke u bërë një angazhim i jashtëzakonshëm që të kemi një administratë shumë më efikase dhe tashmë projektligjet dhe reformimin e administratës janë miratuar. Qeveri po bën punë të madhe edhe në infrastrukturën rrugore, në mënyrë që të hapet mundësia dhe buxheti në të ardhmen të shfrytëzohet për sektorin e ekonomisë, bujqësisë, turizmit, sportit, kulturës, arsimit, shëndetësisë dhe të gjitha sferave të tjera. Besoj se në të ardhmen do të ketë një angazhim më të madh,

sidomos për shpërndarjen e mirë të buxhetit sa iu përket komunave.

**"Epoka e re":** Do të ketë fokus edhe në aspektin e jashtëm, pra në arenën ndërkombëtare meqë, si duket, në vitin e parë të Qeverisë Haradinaj politika e jashtme ka mbetur pa trajtimin e duhur.

**Isufi:** Tani do të ketë një ofensivë sa i përket politikës së jashtme, sepse është faza kur duhet të arrihet marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Por, Serbia ende po e mban një frymë të politikës së Millosheviqit e cila ende Kosovën e mban në Kushtetutën e vet dhe është një proces shumë i vështirë, prandaj duhet të ketë një angazhim të përbashkët të të gjitha forcave politike dhe institucionale në Kosovë. Duhet të ketë një konsensus për çështjet madhore në mënyrë që edhe politika e jashtme të jetë frytdhënëse sa iu përket integriteteve që e presin Kosovën. Serbia nuk po heq dorë edhe më tutje duke penguar Kosovën qoftë për t'u anëtarësuar në mekanizmat ndërkombëtarë. Dhe, kjo tregon fytyrën e vërtetë të Serbisë, e cila nuk është duke u këndellur për t'u ballafaquar me të vërtetën.



Republika e Kosovës ka përkujtuar viktimat e sulmit terrorist më 11 shtator 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA)

# Kosova dhe Amerika, gjithmonë bashkë, në ditë pikëllimi dhe gëzimi

Sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) ishin kundër vlerave perëndimore të civilizimit dhe tërë botës demokratike. Kështu kanë vlerësuar liderët shtetërorë të Kosovës në përkujtimin që ua bënë viktimave të këtij sulmi terrorist



EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 SHTATOR - "Kosova dhe Amerika janë bashkë edhe në këtë ditë dhe do të jenë gjithnjë. Lutjet tona shkojnë për familjet e viktimave të sulmeve të 11 shtatorit. Falënderoj ambasadorin Delawie për nderin që na bëri sot që të jetë bashkë me ne", kështu ka thënë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, pasi ka bërë homazhe në përkujtim të viktimave të sulmit terrorist të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në ceremoninë e homazheve, të organizuar nga kryeministri Ramush Haradinaj, ishin të pranishëm edhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ish-presidentja

Atifete Jahjaga, ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie, ambasadorë të tjerë të akredituar në Kosovë, ministra të kabinetit qeveritar dhe punonjës të Zyrës së Kryeministrit, të cilët nderuan viktimat e sulmit terrorist të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se 11 shtatori ka qenë sulm mbi vlerat civilizuese, ka qenë provë për gjithë botën demokratike, për t'iu përgjigjur një fryme, e cila ka qenë çnjerëzore. "Sot, kaq vjet pas asaj dite të rëndë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe bota e civilizuar ka triumfuar. Çdo ditë e më tepër po mbizotëron arsyeja, në të njëjtën kohë vlerat demokratike, vlerat tona civilizuese perëndimore nuk

ka askush që mund t'i cenojë", ka thënë Veseli, duke shtuar se Kosova do të jetë së bashku me Amerikën, sepse Amerika është shpëtimtare e Kosovës dhe do të jemi bashkërisht përjetë.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka thënë se qytetarët e Kosovës bashkëndiejnë me familjet të cilat humbën më të dashurit e tyre më 11 shtator 2001. Ai ka theksuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës po dëshmojnë gjithnjë se janë të përkushtuara për barazi në botë. Limaj ka thënë se Kosova është rreshtuar krahas ShBA-së dhe botës demokratike në luftën kundër terrorizmit.

Ndërkaq ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie, ka pohuar se Shtetet e Bashkuara përkujtojnë sulmet e 11 shtatorit dhe me këtë rast falënderojnë Qeverinë dhe popullin e Kosovës

për partneritetin dhe mbështetjen në këtë situatë. "Sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 në Nju Jork, Uashington dhe në Pensilvani terrorizuan gjithë botën dhe populli i Kosovës gjithë kohën ka qenë me ne", është

shprehur ambasadori Delawie.

Po të martën në të gjitha kazeramat e Forcës së Sigurisë të Kosovës është përkujtuar 17-vjetori i sulmeve terroriste në Nju Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

## Thaçi: Sulmet terroriste të 11 shtatorit në ShBA ishin kundër vlerave perëndimore

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, me rastin e 17-vjetorit të sulmeve terroriste në ShBA, ka thënë se këto sulme të shëmtuara ishin kundër vlerave perëndimore të civilizimit dhe tërë botës demokratike. "U bënë 17 vjet nga sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto sulme të shëmtuara ishin kundër vlerave perëndimore të civilizimit dhe tërë botës demokratike. Viktima të tyre ishin shtetasit e mbi 70 vendeve të ndryshme të botës, që sot e tërë bota i kujton. Edhe populli ynë bashkëndjen me të gjithë popujt që humbën më të dashurit e tyre në këto sulme barbare që tronditën botën. Kosova, si pjesë e aleancës globale të krijuar më pas, është munduar gjithmonë ta japë kontributin në këtë luftë të pandalshme kundër fundamentalizmit, ekstremizmit dhe terrorizmit", ka thënë Thaçi.



# Veseli e O'Connelli nënshkruajnë sërish marrëveshje për rekrutimin e pozitave të larta

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Prishtinë, Ruari O'Connell, kanë nënshkruar të martën memorandum bashkëpunimi për vazhdimin e projektit për rekrutimin e zyrtarëve profesionalë në pozita të larta drejtuese.

Kryeparlamentari Veseli ka thënë se ka pasur kritika lidhur me procesin e rekrutimit të njerëzve në pozita të tilla prandaj, sipas tij, ka filluar dhe po vazhdon ky projekt i cili do t'i luftojë pabarazitë dhe do të ndihmojë në përzgjedhjen e kuadrove profesionale. "Kosova

ka nevojë për ambient të pakorruptuar. Jam i vendosur t'i shkoj deri në fund dekriminalizimit politik dhe shoqëror. Kjo është duke ndodhur duke iu falënderuar këtij bashkëpunimi. Ky projekt ndihmon Kosovën të ecë përpara dhe ta rrisë besueshmërinë e kuadrove profesionale", ka theksuar kryeparlamentari Veseli. Ai ka thënë se institucionet e Kosovës, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, duhet ta bëjnë edhe vetingun për sistemin e drejtësisë, policisë, por edhe për politikën, në mënyrë që personat që shërbejnë dhe udhëheqin qytetarët të jenë të pastër dhe kredibil.

Ambasadori Ruari O'Connell ka

pohuar se nënshkrimi i këtij memorandum është një nga lajmet më të mira në dy vjetët e fundit, nëpërmjet të cilit, sipas tij, do të adresohen rastet e nepotizmit. "Më vjen shumë mirë që pas dy vjetëve po nënshkruajmë prapë marrëveshjen për rekrutimin e pozitave të larta. Suksesi i këtij projekti do të jetë suksesi i Kosovës dhe dështimi i këtij projekti është dështim i Kosovës. Kosova ka kuadro profesionale që duhet t'u jepet mundësi. Ftoj profesionistët të aplikojnë. Sfidojeni veten dhe sfidojeni institucionin", ka deklaruar ambasadori O'Connell. Ai ka shtuar se gjatë dy vjetëve të implementimit të këtij projekti shumë profesionistë janë emëru-



ar në pozita të larta udhëheqëse. Diplomati britanik ka theksuar se Kosova ka shumë kuadro të përgatitur të cilëve duhet t'u jepet

mundësia dhe se projekti ka ndihmuar që njerëzit profesionistë të emërohen në pozita të larta.



Shoqëria civile vazhdon të organizojë tryeza lidhur me dialogun Kosovë - Serbi

# Ndryshimi i kufijve, antikushtetues

Ndryshimi i kufijve të shtetit të Kosovës është vlerësuar antikushtetues nga njohësit e rrethanave kushtetuese dhe politike. Në një tryezë të organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS), ata kanë vlerësuar se kjo ide është e rrezikshme politikisht dhe e paqëndrueshme



EPOKA  
ERE **Arbisa SHEFKIU**

**PRISHTINË, 11 SHTATOR** - Njohësit e rrethanave kushtetuese dhe politike në vend e kanë vlerësuar antikushtetues ndryshimin e mundshëm të kufijve të Kosovës. Sipas tyre, korrigjimi i kufijve është i rrezikshëm dhe i paqëndrueshëm. Në tryezën "Humbësja e madhe e dialogut: Diskutim mbi parimet dhe strategjitë që parandalojnë institucionet e Kosovës t'i zhbëjnë karakteristikat unike të Kosovës", të organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS), Enver Hasani, ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ka thënë se lëvizja dhe ndryshimi i territoreve është jokushtetues. "Diskursi rreth dialogut flitet sikur të mos kishte asnjë ditë përvojë si shtet sovran. Çështja e

pozitës së shefit të shtetit nën një shtet si është Kosova, shef i shtetit, nuk është shef i ekzekutivit. Çështja e disponimit me territore është çështje e sovranit. Kosova kur është krijuar si shtet ka treguar që rasti i Kosovës nuk ka ekzistuar kurrë më herët dhe jemi sui-generis", ka thënë Hasani. Sipas tij, është gabim që Kosova të lëvizë jashtë vijave të GjND-së. "GjND-ja ka thënë që ne e njohim Kosovën me atë territor që ka qenë në ditën e shpalljes së pavarësisë. Çdo nënshkrim i çdo marrëveshje që bëhet jashtë organeve kushtetuese nuk është i ligjshëm. Kosova nuk është shkëputur nga ish-Jugosllavia, por nga Serbia dhe ne trashëgojmë të gjitha të drejtat dhe detyrat. Nëse futemi jashtë lojës së politikës së GjND-së ne pranojmë standardet e krijuara nga Serbia për shkëputje të territorit", ka deklaruar Hasani.

Analisti politik Belul Beqaj ka

vlerësuar se arsyet pse shqiptarët në Serbi dhe serbët në Kosovë janë të pakënaqur, të pasigurt, është se nuk kanë të bëjnë me territoret ku ata jetojnë, por me mënyrën se si po qeveriset në ato territore. "Në rastin e Serbisë, nëse shqiptarëve të Luginës u bëhet zgjedhja, mbetet e pazgjidhur çështja e pakicave të tjera. Në rastin e Kosovës situata komplikohet sepse një pjesë e serbëve e zgjedhin problemin duke iu bashkuar Serbisë, ndërsa pjesa tjetër që jetojnë jashtë veriut do

të ballafaqohen edhe me probleme më të mëdha. Korrigjimi nuk është zgjidhje afatgjatë e as e qëndrueshme. Korrigjimi është nxitje për formimin e shteteve etnike të cilat me kohë homogjenizohen", ka deklaruar Beqaj. Ndërsa Lulzim Peci, drejtor ekzekutiv i KIPRED-it, ka vlerësuar se logjika e korrigjimit të territoreve është mashtrimi më i madh që po u bëhet qytetarëve të këtij vendi. "Bashkimi Evropian ka filluar me logjikën e asaj për bashkëpunim dhe jo shkëmbim

të territoreve. Unë jam optimist se edhe vetë Mogherini e pranoi se ky proces i negociatave nuk do të përfundojë edhe vitin e ardhshëm, e kjo është disfatë për kabinetin e saj", është shprehur ai, duke shtuar se ajo çfarë i duhet Kosovës në këtë kohë është një durim strategjik. "Mendoj se ata aktorë që e kanë sjellë Kosovën deri në këtë pikë nuk duhet të jenë në krye të bisedimeve. Logjikën e konferencës së Mynihut është duke e shtyrë Putini", ka thënë Peci.

## Hoxhaj: Në fazën finale të dialogut mbështetja e ShBA-së është e rëndësishme

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka theksuar rolin dhe rëndësinë e mbështetjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për fazën finale të procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se marrëveshja finale në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të ketë garanci të zbatimit si nga Bashkimi Evropian, po ashtu edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës



**BLED, 11 SHTATOR (ER)** - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, po qëndron në Slloveni, ku po merr pjesë në Forumin Strategjik të Bledit. Në margjina të këtij forumi, zëvendëskryeministri Hoxhaj ka takuar zëvendësndihmëssekretarin amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, ministrin e Jashtëm të Malit të Zi, Srdjan Darmanoviq, zëvendësministrin e Punëve të Jashtme të Greqisë, Terens Quick, si dhe personalitete të shumta që po marrin pjesë në këtë organizim. Në takim me Palmerin, zëvendëskryeministri Hoxhaj ka theksuar rolin dhe rëndësinë e mbështetjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për fazën finale të procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Hoxhaj ka thënë se marrëveshja finale në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të ketë garanci të zbatimit si nga Bashkimi Evropian, po ashtu edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Roli dhe mbështetja e ShBA-së në fazën e fundit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është jashtëzakonisht e rëndësishme. Ky proces duhet të përfundojë me njohje të ndërsjellët dhe anëtarësim të Kosovës në OKB, ndërsa është e nevojshme garancia e zbatimit të kësaj marrëveshjeje finale nga Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja", ka deklaruar zëvendëskryeministri Hoxhaj.

Ai ka treguar se në margjina të Forumit Strategjik të Bledit, me zëvendësndihmëssekretarin amerikan të shtetit, Matthew

Palmer, kanë diskutuar për marrëdhëniet e shkëlqyeshme në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe për perspektivën euroatlantike të Kosovës.

Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka takuar edhe ministrin e Punëve të Jashtme të Malit të Zi, Srdjan

Darmanoviq, me të cilin kanë diskutuar për marrëdhëniet bilaterale dhe për mënyrat e bashkëpunimit mes dy shteteve në rrugën e përbashkët drejt integritimit euroatlantik.

Hoxhaj ka zhvilluar takime dypalëshe edhe me zëvendësministrin e Punëve të Jashtme të

Greqisë, Terens Quick, me të cilin kanë diskutuar edhe për njohjen e Kosovës nga ky shtet. Ai ka takuar edhe sekretarin e përgjithshëm të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, Goran Svilanoviq, si dhe sekretarin e përgjithshëm të Ligës Arabe, Amre Moussa.



# OECD-u sugjeron që të punohet më shumë për rritjen ekonomike në Kosovë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe me mbështetje nga Komisioni Evropian, kanë organizuar konferencën me temën "Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore: Pikëpamja për politikën 2018", ku edhe kanë lansuar raportin hulumtues.

Ushtruesja e detyrës së ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Arbëreshë Krasniqi, ka deklaruar se do të angazhohen për t'i arritur rekomandimet e OECD-it nga ky raport. Ajo u zotua se MTI-ja do ta vazhdojë punën për ngritjen e konkurrueshmërisë. "Përmes këtij raporti mund ta vlerësojmë përparimin e reformave politike pro konkurruese në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor, siç janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Serbia dhe Mali i zi. Do të angazhohemi për implementimin e rekomandimeve, sidomos të atyre që kemi ngecje, me shpresë se në publikimin e rad-

hës do të jemi në nivel më të lartë se në këtë ditë", ka deklaruar Krasniqi.

Riccardo Serri, udhëheqës i Sektorit Publik, Ekonomik dhe për Integritet Evropian në Zyrën e BE-së ka treguar se BE-ja ka dhënë 10.7 milionë euro për investime në fushën e konkurrueshmërisë. Ai ka thënë se konkurrenca është element shumë i rëndësishëm për çdo shtet që mendon të bëhet anëtar i BE-së.

Serri ka theksuar se për këtë arsye edhe e kanë financuar këtë projekt. "Është shumë e rëndësishme që Bashkimi Evropian është këtu t'ju shpjegojë arsyet kryesore, pse është kaq e rëndësishme çështja e konkurrencës për çdo vend që synon të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian një ditë. Mendoj se ky është një element thelbësor dhe arsyeja vendimtare që na solli drejt financimit të këtij projekti për të krijuar bashkëpunim shumë të mirë me OECD, që sot u paraqit nga të gjithë ne në këtë tryezë", ka thënë Serri.

Kurse Marzena Kisilewska, udhëheqëse e Divizionit të OECD-së për Evropën



Juglindore, ka thënë se ky raport është fryt i një pune afatgjatë. Ajo ka deklaruar se ky raport është një nga vlerësimet më të mëdha që ka bërë OCDE-ja për ndonjë shtet. Sipas saj, duhet më shumë përpjekje për ngritjen ekonomike dhe, për këtë, sipas saj, duhet të rritet edhe bashkëpunimi në mes të ministrive. "Perspektiva e konkurrueshmërisë është një tregim i sfidave dhe mënyra se si do të trajtohen këto me sukses. Mundësi

të caktuara në raste të caktuara janë anashkaluar, por të gjitha këto janë identifikuar. Pra, është një dokument i rëndësishëm së procesit dhe në një mënyrë e hap një kapitull të ri, një kapitull të cilin ju duhet ta shkruani", ka thënë ajo. Ndërsa Jakob Fexer, menaxher i projektit nga Divizioni i OECD-së, gjatë këtij hulumtimi ka hasur koordinim jo të mirë në dizajnimin e politikave në Kosovë. Sa iu përket politikave tatimore, ai ka thënë se të ardhurat nga tatimet

janë rritur. Ai ka thënë se një pengesë tjetër që kanë hasur gjatë këtij hulumtimi është dominimi i ndërmarrjeve të vogla nga ato të mëdha.

Ky raport paraqet sfidat kryesore ekonomike dhe pengesat strukturore të konkurrueshmërisë për shtetet e Evropës Juglindore dhe sipas këtij raporti, zbatimi i dobët dhe monitorimi i papërshtatshëm vazhdojnë të pengojnë për reformat strukturore në këto shtete.

## Kosova, pjesë e panairit më të madh të ekonomisë digjitale

KOLN, 11 SHTATOR (ER) - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë prezanton Republikën e Kosovës me një shtand në panairin më të madh të ekonomisë digjitale, marketingut dhe inovacionit DMEXCO 2018, vendi kyç ku takohen liderët botërorë të ekonomisë digjitale, marketingut dhe inovacionit.

Me kërkesë të komunitetit të ekonomisë digjitale dhe në pajtim me programin e Qeverisë dhe planin e punës së Ministrisë për vitin 2018, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do ta përfaqësojë Kosovën në panairin më të madh të ekonomisë digjitale, marketingut dhe inovacionit, DMEXCO 2018, i cili mbahet më 12 dhe 13 shtator në Koln të

Gjermanisë.

Përmes këtij panairi të mirënjohur, synohet ndërkombëtarizimi i ekonomisë kosovare, thithja e investimeve të huaja, ndërtimi i urave të bashkëpunimit mes komunitetit tonë, bashkëpunëtorëve të huaj, si dhe promovimi i Republikës së Kosovës dhe inkuadrimi në zinxhirët e vlerave ndërkombëtare të ekonomisë. Republika e Kosovës do të përfaqësohet krahe për krahe me liderët botërorë të fushës, madje në të njëjtën hapësirë me "Google", "Facebook", "Adobe" dhe të tjerë. Në Koln do të jenë të pranishëm edhe një numër i konsiderueshëm i ndërmarrësve të Kosovës të cilët janë edhe iniciatorë të kësaj pjesëmarrje.



## Fillon faza e gjashtë e dezinfektimit hapësinor në Komunën e Prishtinës

Prishtinë, 11 shtator (ER) - Të martën ka filluar faza e gjashtë e dezinfektimit hapësinor në Komunën e Prishtinës. Sipas njoftimit të Komunës së Prishtinës, kjo ditë është zgjedhur pas të gjitha përgatitjeve teknike dhe operative nga ana e komunës dhe kompanisë pasi që parashikimet klimatike sig-

urojnë një javë me mot stabil dhe pa reshje. "Reshjet gjatë procesit të dezinfektimit e bëjnë të paefektshëm aksionin. Duke u bazuar në këto të dhëna, sivejet do të dezinfektohet një sipërfaqe e përgjithshme mbi 6 000 hektarë, duke përfshirë edhe zona rurale ku ka potencial të lartë të zhvillimit të këtyre

insekteve. Edhe këtë vit do të përdoren preparatet e sigurta të regjistruara për përdorim në vendet e Bashkimit Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Dezinfektimi do të bëhet çdo ditë duke filluar nga ora 19:30

deri në orën 23:30. "Bashkëpunimi i qytetarëve në këtë proces është i një rëndësie të veçantë për suksesin e këtij procesi. Andaj lutem të gjithë qytetarët për bashkëpunim në mënyrë që ky aktivitet të jetë sa më i suksesshëm. Gjatë kohës së dezinfektimit, qytetarët duhet t'i mbajnë dritaret e mbyllura,

që mos të futen insektet brenda dhe t'i kufizojnë daljet nëpër hapësirat ku është duke u kryer dezinfektimi, së paku për një orë. Gjithashtu, u bëhet thirrje shoqatave të bletarëve për kujdes të shtuar gjatë kësaj periudhe", është theksuar në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



# Punëtorët e KEDS-it kërkojnë rritje të pagave

Punëtorët e Kompanisë së Kosovës për Distribim dhe Furnizim të Energjisë Elektrike (KEDS) kanë protestuar të martën, duke kërkuar rritjen e pagave dhe zbatimin e kontratës kolektive. Përfaqësues të Sindikatës së Punëtorëve kanë bërë me dije se në këtë kompani është rënduar gjendja për shkak të mosrealizimit të kërkesave të punëtorëve. Ata kanë paralajmëruar grevë të përgjithshme nëse nuk u rriten pagat



EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 11 SHTATOR** - Para ndërtesës së Kompanisë së Kosovës për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) në Prishtinë dhe para objektit të Qeverisë të martën qindra punëtorë të KEDS-it kanë protestuar duke kërkuar të drejtat e tyre sa iu përket ngritjes së pagave dhe zbatimit të kontratës kolektive.

Kryetari i Sindikatës "Elektro Kosova", Hysni Gashi, ka thënë se nga viti 2015 kërkojnë ngritjen e pagave dhe zbatimin e kontratës kolektive por, sipas tij, kanë hasur në vesh të shurdhër nga menaxhmenti i KEDS-it. "Pagat tona janë në nivel mjaft të ulët. Mezi ia dalim

të mbijetojmë me to. Ne mburremi me punën që e bëjmë, mirëpo do t'ia bëjmë me dije menaxhmentit të KEDS-it, se nuk lejojmë të nëpërkëmbet djersa e punëtorëve", ka thënë Gashi.

Leonora Lokaj, nënkryetare e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), u dha mbështetje kërkesave të punëtorëve të KEDS-it. "BSPK-ja gjatë gjithë kohës ka qenë e njohur për padrejtësitë e menaxhmentit të KEDS-it që po ua bënë punëtorëve, duke filluar nga paga deri të mosimplementimi që mos të merren parasysh vitet e punës. Shpresoj që sa më shpejt t'i arriji ato që po kërkon", ka thënë Lokaj. Fehmi Pajaziti, kryetar i Këshillit Grevist, ka bërë me dije se nuk është arritur asnjë rezultat pas

takimit me menaxhmentin në lidhje me kërkesat e punëtorëve të KEDS-it për ngritje të pagave. "Nuk ka asnjë rezultat, sepse shuma e propozuar nga ZRrE është pak. Ne vazhdojmë bashkërisht, para Qeverisë, dhe u themi se nëse nuk rriten pagat, punëtorët do të hyjnë në grevë të përgjithshme dhe do të ketë kolaps energjetik", ka treguar

Gashi. KEDS-i përmes një komunikate për medie ka reaguar lidhur me protestën. "Ne jemi të vendosur dhe të përkushtuar që t'i përmirësojmë kushtet dhe përfitimet e punëtorëve tanë dhe këtë synojmë ta arrijmë në një bashkëpunim të ngushtë me sindikatat dhe entitetet e tjera. Siç kemi bërë deri tani, veprimet tona që kanë të bëjnë me punëtorët dhe përfitimet e tyre, ne i ndërmarrim në koordinim me sindikatat, në të njëjtën kohë dëshirojmë ta njoftojmë opinionin se ne jemi kompani që vepron me rregullat e ZRrE-së dhe për këtë arsye çdo shpenzim, përfshirë edhe shpenzimet e përfitimeve të punëtorëve, duhet të jenë të aprovuara nga rregullatori, siç ne kemi kërkuar për vite me radhë", është thënë në komunikatën e KEDS-it.

KEDS-i ka bërë me dije se do ta respektojë të drejtën e punëtorëve për të protestuar, duke shpresuar

në koordinim sa më të mirë me organizatorët për të siguruar që operimet e kësaj kompanie të mos ndërpriten. "Duhet pasur parasysh që ne jemi kompani që ofron shërbime për të gjithë konsumatorët, që nga fillimi i operimit tonë në Kosovë ne kemi punuar në bashkëpunim të ngushtë me sindikatat për t'i përmirësuar kushtet e punës së punëtorëve tanë në çdo fushë, si për përfitimet ashtu edhe për sigurinë në vendin e punës. Edhe njëherë ne sigurojmë që do ta vazhdojmë bashkëpunimin me sindikatat në përpjekjet për përmirësimin e operimeve tona, përfshirë edhe kushtet dhe mirëqenien e punëtorëve, me objektivin e qartë për të ofruar shërbim sa më të mirë për konsumatorët", është thënë në komunikatën e KEDS-it.

Protesta e punëtorëve të KEDS-it kishte filluar nga ora 8:00 dhe ka vazhduar deri në orën 16:00.



## Investitorët evropianë publikojnë rekomandimet për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës

**PRISHTINË, 11 SHTATOR (ER)** - Për herë të parë në Kosovë do të publikohet dokumenti më i rëndësishëm për sektorin privat, i quajtur "White Book 2018". Ky dokument, i cili do t'i dorëzohet Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve relevante, identifikon barrierat biznesore me të cilat investitorët ballafaqohen në baza ditore në Kosovë. Për më shumë ky dokument ofron edhe rekomandime konkrete për eliminimin e barrierave në harmoni me praktikën dhe direktivat evropiane.

Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, Shpend Balija, ka thënë se investitorët evropianë janë investitorët më të mëdhenj në ekonominë e vendit

tonë. "Mund të konstatojmë se rekomandimet e tyre janë shumë legjitime për ta bërë Kosovën një vend sa më atraktiv për investimet e huaja direkte (IHD). Gjithashtu, eliminimi i barrierave biznesore nënkupton rritjen e firmave si dhe krijimin e vendeve të reja të punës për të cilat Kosova ka mjaft nevojë", ka thënë Balija. Publikimi i këtij dokumenti do të bëhet më 20 shtator në konferencën e nivelit të lartë të organizuar nga Këshilli i Investitorëve Evropianë, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, si dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ku të pranishëm do të jenë të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare.





# I kthyer në vendin e krimit



Nga Bedri ISLAMI

Presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, ishte në këtë fundjavë vizitor në Kosovë. Bëri mirë që shkoi. Jo për tjetër, por edhe një herë, i gjithë mentaliteti, paraqitja dhe mendësia serbe, u shfaq e plotë dhe në të nuk kishte asgjë të papritur për shqiptarët e Kosovës. Në fund të fundit, me fjalimin e tij të së dielës, ai saktësoi se qendra e mendimit politik në Beograd nuk ka ndryshuar dhe vazhdon të mos ndryshojë. Ndryshe nga sa paraqitet në takimet bilaterale apo me funksionarë të lartë të Brukselit, në bisedat me zonjën Merkel apo në paraqitjet televizive evropiane, Vuçiqi është, pa asnjë dallim esencial, vazhdim i politikës së Millosheviqit në Kosovë dhe i njëjti birrëmbajtës në tavolinën e Sheshelit.

Asgjë e keqe nuk vjen vetëm për të keq. Edhe paraqitja nacionaliste e nivelit të egërsuar e Vuçiq, në fund të fundit, duhet të mbushë në mend politikën shqiptare se serbët asgjë nuk kanë mësuar nga humbjet, nuk kanë asnjë pendim nga e

shkuara, janë të gatshëm përsëri të ndezin flakët e urrejtjes dhe këtë nuk duan vetëm në një drejtim: drejt jugut, ku është shteti i Kosovës, por me të gjithë fqinjët e tij.

Është një mësim për politikën në Prishtinë, ku Vuçiqi i Brukselit nuk është i njëjtë me atë që turfullon para mbështetësve të tij; nuk është ai që bie dakord në bisedat para-prake për të njohur shtetin e Kosovës dhe për të bërë një ndryshim të kufirit në shkëmbim të më shumë të drejtave për serbët e Kosovës; nuk është ai që duke iniciuar një amnisti të përgjithshme në të dyja anët, synon të ulë tensionin politik, kombëtar e qytetar; nuk është ai që shkoi në Kosovë me dafinat e paqes, por që kërcënoi rishtas, duke sjellë si shembull të një burrë shteti të madh serb, pikërisht vrasësin masiv, Millosheviqin.

Është një mësim edhe për politikën në Tiranë, e cila shpeshherë mund të mendojë se njeriu i sjellshëm - rëndesë nga koha e birrëmbajtjes së frazave miqësore, nuk është i njëjtë me atë që synon ta rifusë Kosovën nën mantelin e përgjakur serb, por që vjen dita dhe ai shfaqet ashtu si ka qenë në të vërtetë dhe, si duket, do të mbetet edhe për shumë kohë.

Në fakt ai u kthye në vendin e krimit të fundit serb, që ishte po aq i përgjakshëm sa edhe në Kroaci dhe në Bosnje. Duke u kthyer në

këtë vend dhe me të njëjtën mendësi, ai nuk mund të dilte nga vetja dhe, edhe po të guxonte ta bënte këtë, si guxon jo pak herë në bisedimet me përfaqësues të lartë evropian, sidomos me Zonjën Mogerini, ai nuk do të mund të mbante vendin e tij si president. Sepse, e gjithë kupola drejtuese e sotme e Beogradit, ka ndërruar emrat, por jo qëndrimin ndaj një çështje të humbur.

Me këtë mendësi të atij që kthehet edhe një herë në vendin e krimit, ai synoi të shkonte edhe në Drenicë, në zonën ku janë bërë masakrat e para dhe më të përgjakura serbe. Nuk kërkoi të shkonte për të kërkuar ndjesë, por si shëmbëlltërrë e pushtetit të tij, i cili, edhe pse mund të ketë petka moderne, është po aq kasap sa edhe më herët.

Sidoqoftë, edhe pse i trullësuar nga ajo që i ndodhi në Drenicë, Vuçiq

mësoi disa gjëra që do t'i vlejnin edhe në të ardhmen.

Ai mësoi se, edhe po të ketë mundësi të bëjë për vete një pjesë të klasës politike në Kosovë, në fund të fundit, rrugët do të jenë të prera dhe të pafund. Mësoi se, me gjithë ecejaket e tij, ka një kufi që ai duhet ta respektojë dhe të kthehet mbrapsht. Refuzimi i Drenicës, kjo do të kishte ndodhur edhe në zona të tjera, për t'i bërë vend një radikali Sheshelist, pavarësisht se ai bisedon me krerët kushtetues, do të thotë shumë për Beogradin, i cili, edhe pse synoi të trembë me lëvizjen e ushtrisë drejt Kosovës, e di krejt mirë se kjo është një disfatë e hidhur.

Vuçiqi mësoi se edhe drejtuesit e lartë të Kosovës, të cilët, herën e parë i dhanë leje të udhëtonte drejt Drenicës, janë të tërheqshëm, pikërisht atëherë kur e rishohin se nuk janë ata që vendosin.

Ndaj, tani, në bisedimet që mund të vazhdojnë një ditë, ai, pas hijes së kujtdo qoftë si përfaqësues i Kosovës, duhet të shohë edhe ata që lëvizin dhe që janë në të vërtetë fryma që i duhet Kosovës.

Në fund të fundit, ai mësoi se edhe presidenti i Serbisë, pavarësisht tonit e mesazhit ultranacionalist, nuk mund të bëjë më shumë se kaq; atij i duhet dhënë leje për të vizituar një shtet fqinj; atij i duhet shikuar e miratuar agjenda e lëvizjes; atij i priten rrugët kur lëvizja e tij synon të destabilizojë. Si çdo vend i pavarur.

Vizita e Vuçiqit, jam i bindur, se do t'i sjellë përfitimet e saj edhe nga mendimi politik në Kosovë.

Premtimet e Vuçiqit në Bruksel nuk duhen marrë kurrë të njëmendta dhe seriozisht. Ai është në gjendje të ndryshojë premtimet e tij për hir të politikës së ditës, por kjo nuk ka të bëjë me Kosovën.

Pas vizitës dhe fjalës së tij, Prishtina zyrtare duhet të ketë një ritëm tjetër: Ajo nuk duhet të ulet rishtas në tryezën e bisedimeve pa u vënë pikat mbi "i"; pra, pa u qartësuar gjërat.

Dhe gjëja e parë që duhet të jetë e qartë edhe për Vuçiqin, është se po bisedojnë përfaqësues të dy shteteve fqinjë që, më parë se të bëjnë fjalë për programe dhe marrëveshje, duhet ta njohin njëri-tjetrin. Nëse ata nuk e njohin njëri-tjetrin, nuk kanë as se për çfarë të bisedojnë.



## Bahtiri e Kryeziu diskutojnë për rritjen e llogaridhënies së institucioneve lokale

MITROVICË, 11 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, të martën ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të KDI-së, Ismet Kryeziu, me të cilin kanë diskutuar për projektin më të ri "Rritja e llogaridhënies së institucioneve lokale", të mbështetur nga Ambasada e Britanisë ku pjesë e këtij projekti do të jetë edhe Komuna e Mitrovicës. Drejtori Kryeziu e ka njoftuar Bahtirin se përmes këtij projekti do të bëhet identifikimi i çështjeve që i shqetësojnë qytetarët nëpër fshatra, lagje, në mënyrë që këto prioritet të përfshihen në planin komunal për vitin e ardhshëm, të rritet pjesëmarrja

në vendimmarrjen lokale dhe të monitorohet puna e qeverisjes lokale.

Kryetari Bahtiri ofroi mbështetjen e plotë për realizimin e këtij projekti në Komunën e Mitrovicës, duke theksuar se ai dhe ekzekutivi janë të përkushtuar për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha institucionet komunale. "Unë ju garantoj se gjithë dokumentacioni që ju nevojitet ju do ta keni në shfrytëzim. Nga ardhja ime në krye të komunës të gjitha vendimet kanë qenë transparente dhe në harmoni të plotë me ligjin, dhe në të mund të ketë qasje kushdo që i kërkon", ka thënë Bahtiri.



## Kompania 'Gjakova riciklim' heq falas mbeturinat në lokalitetin 'Kolonia'

GJAKOVË, 11 SHTATOR (ER) - Pas takimit të përbashkët të mbajtur ditë më parë ndërmjet nënkryetarit të Komunës së Gjakovës, Abdullah Hoti, drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Luan Dinaj, përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të UNHCR-së dhe të Caritasit me shërbime në Kosovë, me komunitetin RAE që banojnë në lokalitetin e njohur si "Kolonia", nga përfaqësues të këtyre banorëve është kërkuar dhe më pas është konstatuar si nevojë e domosdoshme pastrimi i mbe-



turenave të shumta që krijohen në këtë lokalitet përmes deponive të egra. Në këtë takim është vendosur që menjëherë të merren masa konkrete për pastrim të ambientit dhe pas kontakteve me pronarin e kompanisë "Gjakova riciklim", Hajdar Podrimja, ky i fundit ka

marrë përsipër që në mënyrë vullnetare dhe pa kompensim t'i kryejë punimet e pastrimit. Duke dashur të përfitohet në kohë, menjëherë ka nisur pastrimi i terrenit, i cila ka goxha hapësirë dhe është duke u punuar me të gjitha kapacitetet që ka në dispozicion firma.

Pastrimin e ambientit të martën e ka përcjellë edhe nënkryetari i komunës, Ramadan Hoti, i cili ka falënderuar kompaninë "Gjakova riciklim" për këtë kontribut si dhe u ka bërë thirrje banorëve të lagjes të jenë më të përkushtuar për ruajtjen e ambientit ku jetojnë.

## Nisin punimet në projektin 'Ulja e niveletës së përroit në fshatin Celinë'

RAHOVEC, 11 SHTATOR (ER) - Në fshatin Celinë të Komunës së Rahovecit të martën kanë nisur punimet në projektin "Ulja e niveletës së përroit në fshatin Celinë".

Në ceremoninë e nisjes së punimeve të pranishëm ishin kryetari Smajl Latifi, drejtori i DBPZHR-së, Berat Duraku, dhe kryesuesi i Kuvendit Komunal, Afrim Dina.

Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë



se ulja e niveletës së përroit në fshatin Celinë dhe pikërisht nga dalja e ujit nga shtrati i këtij për-

roi janë vërshuar shumë toka bujqësore dhe ekonomi familjare. "Përfundimi i këtij projekti hap rrugë për projektin tjetër të ndërlidhur për kullimin e tokave bujqësore të fermerëve të veshëm të këtij fshati", ka thënë Latifi.

Realizimi i këtij projekti është mundësuar nga buxheti i Komunës së Rahovecit, i cili kap vlerën prej 178 000sh euro dhe që ka një gjatësi prej 1 237 metrash.




E rrallë

## Zbulohen tri specie të reja peshqish

Shkencëtarët zbuluan tri specie të reja peshqish, në ujërat më të thella në botë. Ekipi ndërkombëtar gjeti këto gjallesa në Atacama Trench, që ndodhen në Paqësorin Juglindor.

Ekspertët pretendojnë se këto krijesa janë shumë të kompletuara që të jetojnë në një ambient kaq të ashpër, prej 6 500 deri në 7 500 metrash thellë në det.

Trupi i tyre xhelatinoz dhe gjysmë i tejdukshëm mund të shpërbëhet po qe se del në sipërfaqe.



## BARSOLETA E DITËS



- Mirëdita! A bon një birrë t'Pejës?  
- Zotëri, është ora 9:00 e mëngjesit.  
- Mirëmëngjesi! A bon një birrë t'Pejës?



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit  
në ora 16:00

### “INCREDIBLES 2” 3D


I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



## FOTO E DITES



Fotografi e ish-presidentit amerikan George W. Bush më 11 shtator 2001, në ditën kur ShBA-ja u sulmua nga sulmet terroriste


Në ora 18:20

### “FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

### “ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

### “LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

## E jashtëzakonshme

# Helikopteri ushtarak e shndërroi në 'motel'

William Roughton nga Lincolnshire i Anglisë ka shpenzuar 25 mijë euro në një helikopter ushtarak që është nxjerrë nga funksioni për ta kthyer në 'motel'. Fermeri kaloi



gjashtë javë duke u angazhuar për ta kthyer në një hapësirë qëndrimi, pa ia ndryshuar kabinën e pilotit, ndërsa ia shtoi sistemin e ndriçimit dhe aparatit që ia imiton zhurmën origjinale.



### DASHI

Është e udhës që sot të mos irritoni

asnjë njeri me sjelljet tuaja. Mbase ju nuk e kuptoni kur mund t'i lëndoni të tjerët pa shkak.



### DEMI

Nëse keni ndihmën e personave të duhur do

të zhvilloni një projekt mjaft të bukur për të gjithë ju. Në fillim do t'ju shohin mosbesues.



### BINJAKËT

Ndjenjat tuaja do t'ju ftojnë sot t'i jepni

një shans të dytë një personi special për ju, por që ju ka zhgënjyer në një moment të caktuar.



### GAFORRJA

Po e kërkon ngado lumturinë

tuaj dhe ende nuk e keni kuptuar që e keni shumë pranë vetes. E rëndësishme është t'i jepni vëmendjen e duhur.



### LUANI

Nuk po e merrni si duhet një sfidë që

ju ka kanë hedhur sot. Mendoni se mund të jetë e thjeshtë, por në fund të ditës do të gjendeni keq.



### VIRGJËRESHA

E shihni që keni marrë një sjellje të

ndryshme karshi një miku që ka ndarë çdo gjë me ju. Jeni kondicionuar nga sa keni dëgjuar kohët e fundit.



### PESHORJA

Edhe pse shumë persona ju shprehin

me fjalë suportin e tyre, ju e dini që e thonë në mënyrë sipërfaqësore. Janë shumë pak ata që e ndiejnë vërtet.



### AKREPI

Duhet ta rikuperoni kohën e humbur sot

duke u angazhuar në të gjithë projektet që i keni lënë pas dore. Kërkon ndihmë nëse keni nevojë.



### SHIGJETARI

Gjëra të mëdha do të ndodhin për të cilat

deri dje nuk kishit shpresë se mund të realizoheshin. Partneri, shumë i përkushtuar karshi jush.



### BRICJAPI

Nëse nuk doni t'u besoni personave

që keni pranë, të paktën besojni intuitës suaj dhe mënyrës së organizimit të gjërave. Do t'ju shpëtojnë në çast të fundit.



### UJORI

Sot do të ekzagjeroni disi me paranojat tuaja. Jo

çdokush e ka me ju dhe jo çdokush dëshiron t'ju pengojë. Stresi i ditëve të fundit ju ka mposhtur.



### PESHQIT

Jeni duke ndjekur të njëjtën

rrugë prej kohësh, kështu që do ta kuptoni nëse jeni në drejtimin e duhur që në fillim.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SCOTLAND - ALBANIA

1

PORTUGAL - ITALY

1

MONTENEGRO - LITHUANIA

1

## Kosova kërkon një tjetër fitore ndaj Maqedonisë

Të enjten në Prishtinë, Kosova dhe Maqedonia do të përballen në kuadër të parakualifikimeve për FIBA Eurobasket 2021. Kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha, shpreh optimizëm se "Dardanët" sërish do ta mposhtin ekipin kombëtar të Maqedonisë. "Jemi shumë të motivuar. Maqedoninë e kemi mposhtur vitin e kaluar, por mund ta mposhtim prapë para shikuesve tanë", ka thënë Berisha



numër sa më të madh për të na përkrahur, sepse me të vërtetë këta lojtarë e meritojnë mbështetjen e të gjithëve". Për ndeshjen ndaj Maqedonisë ka folur në konferencë për medie edhe kapiteni Dardan Berisha, i cili beson se Kosova sërish do ta mposhtë Maqedoninë. "Jemi shumë të motivuar. Maqedoninë e kemi mposhtur vitin e kaluar, por mund ta mposhtim prapë para shikuesve tanë. Trajneri i ri është me ne, e që është freski për ekip. Ka bërë një punë shumë të mirë me ne. E dimë se çfarë ka qenë kur ka luajtur basketboll. Përvoja e tij na e ka përcjellë neve", ka thënë Berisha. Basketbollisti pejan konfirmon se përgatitjet janë bërë në mënyrë maksimale dhe dëshiron që të enjten palestra të jetë e mbushur me tifozë. Biletat për ndeshjen këtë ndeshje do të dalin sot (e mërkurë) në shitje dhe çmimi i tyre do të jetë 2 euro dhe 10 euro.

do të jetë shumë e mirë dhe se do të kënaqemi me basketboll cilësor", ka shtuar ai. Trajneri i Kosovës, Damir Mulaomerović, ka thënë se Maqedonia ka një skuadër të fortë, por synimet e Kosovës në këtë ndeshje janë të mëdha. "Si trajner jam shumë i lumtur që jam pjesë e këtij grupi. Ne kemi punuar shumë. Skuadra e ka bërë një punë shumë të mirë,

kemi stërvitur me ritëm të lartë. Ne e kemi ndryshuar paksa filozofinë e ekipit dhe përfundimisht do të jemi gati për të enjten. Maqedonia ka ekip shumë të mirë. Ne e kemi kuptuar se së fundi e ka angazhuar një lojtar amerikan, Richard Hendrix, por një gjë e tillë nuk i ndryshon planet tona", ka thënë Mulaomerović, duke shtuar: "Kërkoj nga tifozët të vijnë në

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 11 SHTATOR** - Drejtori i Përfaqësuesve të Kosovës, Granit Rugova, të martën në konferencë për medie e ka bërë publike listën e basketbollistëve që do të paraqiten për Kosovën në ndeshjen ndaj Maqedonisë, e cila zhvillohet të enjten nga ora 20:45, në kuadër të parakualifikimeve për FIBA Eurobasket 2021. "12 lojtarët që do të paraqiten të enjten në parket janë: Mirza Ahmetbasiq, Erjon Kastrati, Dardan Berisha,

Leonard Mekaj, Valon Bunjaku, Scott Bamforth, Rron Ukaj, Ergin Grosha, Lis Shoshi, Fisnik Rugova, Alban Veseli dhe Gëzim Morina", ka thënë Rugova, i cili ka ftuar adhuruesit e basketbollit të jenë në palestër për ta përkrahur ekipin përfaqësues. "Ftoj të gjithë adhuruesit e sportit që në numër sa më të madh të vijnë të enjten në palestër, sepse kemi nevojë për përkrahjen e të gjithëve. 'Dardanët' do të jenë të pranishëm për të na mbështetur, e që janë lojtari ynë i gjashtë në parket. Besoj shumë se atmosfera

## Vihet gurthemeli për qendrën sportive në Greme

"Palestra në Greme është një ndër projektet më moderne që po financohet nga buxheti i shtetit, më saktësisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ky projekt kapital do të kushtojë 1 milion e 200 mijë euro dhe do të përfundojë deri në fund të vitit 2019", ka thënë ministri Gashi



**FERIZAJ, 11 SHTATOR** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, së bashku me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe kryetarin e Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, kanë venë gurthemelin për ndërtimin e qendrës sportive në Greme të Ferizajt. Për ndërtimin e këtij objekti sportiv Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të investojë mjete financiare në vlerë prej 1 milion e 200 mijë euro gjatë vitit 2018. Ky projekt

kapital u vlerësua se është i rëndësishëm së veçantë dhe me interes të jashtëzakonshëm për qytetarët e Gremës dhe vendbanimeve përreth. "Palestra në Greme është një ndër projektet më moderne që po financohet nga buxheti i shtetit, më saktësisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ky projekt kapital do të kushtojë 1 milion e 200 mijë euro dhe do të përfundojë deri në fund të vitit 2019", ka thënë ministri Gashi, i cili me

këtë rast ka bërë me dije se Komuna e Ferizajt vitin e ardhshëm do të bëhet edhe me Qendrën Multifunktionale Kulturore, Rinore dhe Sportive.

"Qeveria e Kosovës dhe unë si ministër jemi të përkushtuar ta përmirësojmë infrastrukturën sportive në vend. Të rinjtë tanë kanë talente të jashtëzakon-

shme. Kemi detyrim t'u krijojmë mundësi të zhvillimit të aftësive të tyre me qëllim që sukseset, nëpër të gjitha disiplinat sportive, mos të na mungojnë", ka shtuar numri një i ministrisë së sportit. Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka deklaruar: "Ky fshat e meriton më së shumti, sepse ka tak-sapaguesit më të mëdhenj të Republikës së Kosovës". Ndërsa kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, u shpreh se po ndihet mirë që banorët e Gremes po bëhen me një qendër të tillë sportive. "Tashmë Ferizaj është kryeqendër e zhvillimit ekonomik dhe Grema është vendbanim i zhvillimit ekonomik", ka thënë Aliu.

## Ballkani ndali Prishtinën, sot derbi Drita - Llapi

**PRISHTINË, 11 SHTATOR (ER)** - Sami Sermahaj ka debutuar me barazim në krye të shtabit teknik në skuadrën e Ballkanit nga Suhareka. Një gjë e tillë tekniku kryeqytetas e ka bërë ndaj ish-skuadrës së vet, Prishtinës, pasi ndeshja e zhvilluar të martën në kuadër të IPKO Superligës përfundoi 1-1. Pjesa e parë u mbyll 0-0, kurse rastet më të mira për

shënim i kishin Besnik Krasniqi i vendësve dhe Arbër Hoxha i mysafirëve. Në pjesën e dytë ishte Prishtina që shënoi e para nëpërmjet sulmuesit Gauthier Mankendan (52), por ky gol nuk e pengoi Ballkanin ta kërkojë barazimin, të cilin edhe e arriti në minutën e 71-të. Autor i golit ishte Blend Baftiu, i cili në të kaluarën e ka djersitur fanellën e skuadrës

nga kryeqyteti. Pas kësaj ndeshje Prishtina ka grumbulluar shtatë pikë, nga tri takimet e zhvilluara. Ndërsa Ballkani ka zhvilluar katër ndeshje dhe ka katër pikë. Edhe ndeshja tjetër e zhvilluar të martën në mes të Drenicës dhe Gjilanit në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj përfundoi me rezultat 0-0. Ishte skuadra kuqezi që kishte me shumë nga ndeshja,

**IPKO SUPERLIGA**  
Ballkani - Prishtina 1-1  
Drenica - Gjilani 0-0  
Të mërkurën takohen:  
Drita - Llapi  
Ferizaj - Feronikeli  
KEK-u - Trepça '89  
Flamurtari - Liria



por nuk arriti t'i konkretizojë në gol rastet e krijuara dhe ndeshja u mbyll pa gola të shënuar. Sot (e mërkurë) zhvillohen katër ndesh-

jet e tjera të xhiros së katërt në elitë. Ndeshja kryesore zhvillohet në Gjilan në mes të kampiones aktuale, Dritës dhe Llapit.



## Ferrari konfirmon: Largohet Raikkonen, vjen Leclerc

Maranello, 11 shtator - Pas tetë sezonesh me Ferrarin është konfirmuar lajmi se piloti Kimi Raikkonen nuk do të vishet më me të kuqe për 2019-n. Ai do të rikthehet në ekipin Sauber që i dha atij debutimin e parë në Formula

1 në vitin 2001. Pilotin tek Ferrari do ta zëvendësojë Carles Leclerc, piloti 20-vjeçar që është një ndër pilotët më të rinj në historinë e Scuderias, i cili do të jetë pranë Sebastian Vettelit në sezonin e ri. Raikkoneni iu

bashkua ekipit pesë vjet më parë, por tashmë vendos të kthehet aty ku e nisi. Ai e ka bërë publik lajmin në llogarinë e vet në "Instagram" duke thënë: "Gjejeni kush do të rikthehet? Dy vjetët e ardhshëm me skuadrën

Sauber F1! Ndihe shumë mirë që rikthehem aty ku gjithçka filloi". Ndërsa zëvendësuesi i tij, Leclerc, në profilin e vet ka shkruar: "Ëndrrat realizohen. Do të garoj për Ferrarin për Kampionatin Botëror në



Formula 1. I jam mirënjohës Ferrarit për mundësinë". Më pas këtë sukses ia ka dedikuar babait të vet që nuk jeton më.

# Panucci, pas humbjes nga Skocia, rrezikon shkarkimin

TIRANË, 11 SHTATOR - Christian Panucci ka lëkundur ndjeshëm pozitën e tij, pas humbjes me Skocinë në Glasgow, një ndeshje në të cilën kuqezinjtë, përpos humbjes, u panë në vështirësi shumë të mëdha. Veç gjendjes jo të mirë fizike, ekipi duket se vuajti ndryshimet e skemës që, siç pohuan edhe lojtarët me zë dhe nën zë, ishin deri-diku të paprovuara. Gjithmonë thuhet se është e lehtë të analizosh kur përfundon gjithçka, por në 10 ndeshje, 9 skema të ndryshme dhe dhjetëra lojtarë të provuar thuajse nuk funksionuan asnjëherë. Kanë qenë rreth 15 lojtarët e rinj që ka grumbulluar trajneri Panucci që nga korriku i vitit 2017, kur mori drejtimin e Shqipërisë, por thuajse asnjëri prej tyre nuk mundi të lërë gjurmë, për të qenë brez i së ardhmes, apo pjesë e ekipit që mban vulën e pasuesit të De Biasit.

Kryefjala e çdo grumbullimi të Christian Panucci ka qenë disiplina, lojtarët që largohen dhe thirren në grumbullimet pasardhëse për përvojën, apo për t'i plotësuar vendet e lojtarëve të dëmtuar e me pak minuta aktivizim. Prania e kapitenit Agolli në këto dy ndeshje u pa vetëm në konferencat për shtyp, ndërkohë që në futboll thuhet se formacioni fitues



nuk ndryshon. Mesfusha e paraqitur mirë në ndeshjen ndaj Izraelit, me Bashën në krye apo Hykën, u ndryshua 3 ditë më pas pa ndonjë arsye bindëse, ndryshim që rezultoi jo i suksesshëm, raporton "TopChannel". Fitorja me Izraelin thjesht i dha një frymëmarrje atmosferës mbytëse të krijuar nga një presion i drejtë rezultatesh. Ndërkohë, tani pas humbjes në Skoci, gjithçka zbret në vendin ku ishte, në të njëjtën atmosferë, presion e pasiguri. Teorikisht jemi me 3 pikë në grupin tonë, aq sa edhe Skocia, por luajmë në

Izrael ndeshjen e ardhshme me frikën se nuk dimë çfarë na pret, kush do të luajë dhe si do të luajmë. Një pikëpyetje që e ka shoqëruar trajnerin Panucci përgjatë të gjithë këtij viti që na udhëheq, edhe pse vlen të thuhet se për fatin e tij jo të mirë, aventura e drejtimit të një përfaqësuese filloi nga një Shqipëri në tranzicion. Shumica e lojtarëve janë pa minuta në këmbë, me dëmtime të shpeshta, disa madje edhe pa ekupe për të luajtur në mënyrë të vazhdueshme, duke sjellë një kolaps mendimi për një zgjidhje të së ardhmes.

# Boateng: Ja pse u largova nga Gjermania

SASSUOLO, 11 SHTATOR - Kevin Princ Boateng është hero në Frankfurt. Ai zhvilloi një sezon fantastik me Ajntrahtin dhe ndihmoi ekipin ta fitonte Kupën e Gjermanisë në finalen me Bayern Munchenin, ku dha asistimin për Rebiqin në golin e fitores. Një festë e madhe për tifozët dhe klubin, sepse kishte 30 vjet që skuadra nuk fitonte një trofe. Në fund të sezonit zgjodhi të largohej dhe rikthehej në Itali, për të qenë më afër familjes që jeton në Milano, por jo vetëm.

31-vjeçari zgjodhi Sassuolon dhe tregon për gjermanen "Bild" shkaqet e këtij vendimi, si dhe flet për maturimin si futbollist dhe njeri. "Krahasuar me Frankfortin, këtu kam autostradën gati për Milano. Këtu janë makaronat, që janë shumë, por shumë të mirë. Së fundmi shkova në një restorant për të ngrënë dhe përfundova në kuzhinë duke përqafuar kuzhinierin. Nuk është normal një ushqim i tillë, por



duhet të tregohem i kujdesshëm që të mos marr shumë yndyra. Më duhet të them që në 3-4 sezonet e fundit po impenjohem më shumë. Më parë nuk isha kaq i mirë sa i përket disiplinës. Gjithmonë duhet të jesh profesionist dhe jashtë fushës. Karrierës sime për momentin i jap notën shtatë, ndonjëherë i afrohem tetës, por ka edhe raste kur kam zbritur poshtë pesës", ka thënë

Boateng, duke shtuar: "Nuk e lashë Gjermaninë vetëm për të qenë afër familjes, por edhe sepse u largua trajneri Kovaç. Para së gjithash, sepse dëshiroja të lija një kujtim të bukur në një ekip gjerman. Është shumë i bukur fakti që një ditë mund të rikthehem në Frankfurt dhe njerëzit do të më prisnin më krahë hapur. Më në fund u largova vetë dhe nuk më larguan të tjerët".

## SHKURT

### Empoli "blindon" Veselin

25-vjeçari Frederik Veseli u përzgjedh nga Christian Panucci në të dyja ndeshjet e Ligës së Kombeve në formacion. Sipas asaj që raporton "Gazzetta dello Sport", klubi i tij, Empoli, ka gati rinovimin për të. Ata duan ta kenë në ekip deri në vitin 2021. Vitin e shkuar futbollisti i kombëtares kuqezi luajti plot 30 ndeshje, prej të cilave 29 si titullar.

### Simeone: Një ditë do të jem trajner i Interit

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, ka konfirmuar se një ditë dëshiron të jetë trajner i Interit, por e ka lavdëruar punën e trajnerit aktual, Luciano Spalletti. "Është e qartë se gazetarët italianë do ta bëjnë këtë pyetje klasike. Gjithmonë kam thënë se një ditë do ta marr pozitën e trajnerit në Inter, e kam gjithmonë në mendje këtë opsion. Ata e kanë një trajner, i cili është duke bërë punë shumë të mirë. Por, edhe unë jam duke kaluar një kohë të jashtëzakonshme me Atletico. Do të ndodhë atëherë kur të ndodhë. 2020, viti i përfundimit të kontratës me Atletico, është larg. Kam ende dy vjet kohë", ka thënë Simeone.

### Crouchi dëshiron të rikthehet te QPR-ja

Peter Crouch ka një dëshirë të fundit para përfundimit të karrierës si futbollist. Sulmuesi anglez ka thënë se dëshiron rikthim në Queens Park Rangers para pensionimit nga futbollit. "Dua të kthehem te QPR-ja para pensionimit nga futbollit", ka thënë Crouch, i cili ka luajtur edhe për Liverpoolin, Aston Villën, Portsmouthin, Southamptonin dhe Tottenham Hotspurin.

### Areola fiton "betejën" me Buffonin

Trajneri i Paris Saint-Germain, Thomas Tuchel, zbuloi se Alphonse Areola është në pole position për të qenë portieri titullar i sezonit, duke fituar duelin me veteranin Gianluigi Buffon. Italiani e nisi sezonin si titullar, duke luajtur në tri takimet e para në Ligën 1, por tashmë trajneri Tuchel duket se ka ndryshuar mendim dhe pritet të vendosë në katërkëndëshin e portës portierin e talentuar francez. Tekniku gjerman bëri me dije se vendimi se kush do të jetë titullar në portë nuk është ende përfundimtar, por Areola duket më i favorizuar.

### Icardi, afër marrëveshjes së re me Interin

Interi është duke finalizuar detajet për rinovimin e kontratës së Mauro Icardit, ndërsa ka mbetur të zgjidhet vetëm çështja e bonuseve. "Nerazzurët" dëshirojnë ta lidhin kapitenin e tyre me klubin për një kohë më të gjatë dhe njëherësh t'ia rritin ose ta heqin nga kontrata klauzolën aktuale prej 110 milionë eurosh. Sipas "Gazzetta dello Sport", zikaltrit i kanë ofruar vazhdim deri në vitin 2023 me një rrogë vjetore ndërmjet pesë dhe gjashtë milionë eurosh. Tashmë ekziston një marrëveshje bazë me lojtarin dhe përfaqësuesit e tij, mirëpo ende janë duke u negociuar bonuset që do të përfshihen në kontratë.





Nr. ref.1213/18  
Datë:11/09/2018

Senati i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, shpall:  
**KONKURS PLOTËSUES**

**për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor në vitin akademik 2018/2019**

Senati i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj në bazë kompetencave të përcaktuara sipas nenit 90 të Statutit të Përkohshëm, në mbledhjen e mbajtur me 27.07.2018 vendosi që të shpall konkurs për vendet e pa plotësuar për vitin akademik 2018/19.

**I. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj në vitin e parë të studimeve, në afatin plotësues të konkursit për vitin akademik 2018/2019, do të regjistrojë 60 studentë të rregullt.
- Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve si në afatin e parë të konkursit, Universiteti do të regjistrojë deri në 2% përkatësisht deri në 8 studentë të rregullt që i takojnë familjes së ngushtë të dëshmorëve (anëtarë të familjes së ngushtë të dëshmorëve janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët). Studentët e kësaj kategorie do të shpërndahen në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
- Si shtesë e numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHIT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në 12 %, përkatësisht deri 47 studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë pasi që dy vende janë të plotësuar në afatin e parë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
- Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHIT-i, mund të pranohen edhe kandidatët nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci ,Medvegja deri 3% përkatësisht 11 studentë pasi që një vend është plotësuar në afatin e parë, si dhe 2%, përkatësisht 8 studentë nga Maqedonia dhe Shqipëria. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshtetësuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrihen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
- Përfshirja kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2, 3 dhe 4, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
- Universiteti nuk do të mundësojë lehtësira për pranim nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
- Të drejtë pranimi në Universitet kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë në njëren prej shkollave publike apo shkollave private të licencuar në Republikën e Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
- Në Universitet mund të pranohen edhe studentët nga shtetet e tjera, në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
- Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet të verifikohet njohja e institucionit shkollor në bazë të listës së MASHIT-it e cila iu dorëzohet të gjitha njësitëve akademike.
- Njohja e diplomave për institucionet jashtë Kosovës do të dokumentohet në bazë të nostrifikimit nga organet kompetente.Vendimi për njohjen dhe barasvleren e diplomës merret në MASHIT.
- Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklarin.
- Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
- Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklarin, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
- Kandidatët për pranim si student të USHAF në vitin akademik 2018/19 nuk mund të konkurrojnë me shumë se në një program të studimit.**

**II. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË**

- Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë 48 orë prej publikimit të rezultateve, përkatësisht nga data 25.09.-26.09.2018 ora 16:00. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet vetëm nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave.
- Kandidatët të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në Administratën Qendrore të USHAF-it me datën 02.10.2018

**III. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE**

- Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:**
  - Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:** Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
    - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
    - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
  - Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:** Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
    - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
    - Suksesi në maturë deri në 30 pikë; dhe
    - Pikët nga lëndët prioritare (3 lëndë) deri në 40 pikë.
 Secila dëftesë e shkollës së mesme të lartë vlerësohet mbi bazën e suksesit më së shumti me 5 pikë.
- Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**
- Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.**
- Përfshirja kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të pikës III, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kriterëve të përcaktuara si në paragrafin 2, 3 dhe 4 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**
- Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
- Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e USHAF.
- Për funksionimin e programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 20 studentëve.
- Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të lëndëve prioritare, e nëse edhe pikët e lëndëve prioritare janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës mesme. Në qoftes e edhe suksesi është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore.
- Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

**IV. AFATET E KONKURISIT**

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

- Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 12.09.2018 deri më 19.09.2018 në ora 16.00 (dokumentet do të pranohen çdo ditë me përjashtim të dielave).
- Ditën e parë të konkursit, me datë 12.09.2018, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora 08.00, ndërsa pranimi i dokumentacionit do të fillojë nga ora 10.00.
- Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:**
  - Certifikatën e lindjes (origjinal).
  - Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal, të noterizuara ose dublikatë).
  - Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose certifikatën të maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal, të noterizuar ose dublikat).
  - Kopjen e letërnjoftimit.
  - Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është: [www.ushaf.net/apliko](http://www.ushaf.net/apliko)**
  - Pagesën prej 2.5 Euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, ndërsa pagesa bëhet në bankë,
  - Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.

4.Me rastin e aplikimit të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e nevojshme si në pikën 3 t'i dorëzojnë në Administratën e Universitetit në dosje (fasikël) të bardhë, për të gjithë kandidatët duhet të jetë unike.

5. Dokumentet në pikën b) dhe c) mund të pranohen duplikat vetëm nëse dëshmohen me vërtetim nga organet kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj. P.s. PAS NJJERRJES SË DOKUMENTEVE DUBLIKAT, DOKUMENTET ORGJINALE NUK MUND TË SHFRYTËZOHEN NGA KANDIDATI PASI QË KY VEPRIM KONSIDEROHET VEPËR PENAL.

6. Njoftimet dhe oraret ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në ueb-faqen e Universitetit.

Data e mbajtjes së provimeve pranuese në Universitet do të jetë me 20.09.2018 ora 9.00.

**7. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë letërnjoftimin, pa të cilën nuk mund t'i nënshtrihen provimit pranues. Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

8. Shpallja e rezultateve të provimit pranues dhe rezultateve preliminare bëhet më së voni, deri më 24.09.2018 ndërsa rezultatet përfundimtare shpallen 27.09.2018 në fakultetet përkatëse si dhe në ueb-faqen e Universitetit.

9.Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.

**10.Në programet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkurs plotësues.**

11.Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen Administratës Qendrore ose ta vizitojnë faqen e internetit: [www.ushaf.net](http://www.ushaf.net)

12.Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në Administratën Qendrore të USHAF-së për të gjitha programet me datën 28.09.2018-29.09.2018

13.Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen 02.10.2018. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, dhe i humbet e drejta e regjistrimit dhe vendet e tyre do të plotësohen me kandidatët e ranguar në listë si të pa pranuar duke filluar nga numrat e parë të listës së kandidatëve jashtë pranimi.

-Procesi i regjistrimit të një kandidati të pranuar konsiderohet i përmbyllur në momentin e fotografimit.  
-Në qoftesë kandidati i pranuar në afatin e caktuar nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga drejta e regjistrimit .

- Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
  - Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit,
  - Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente studentale.
  - Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, vitin e parë të studimeve e kanë falas.
  - Pagesa për një semestër për studentët që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, do të jetë në lartësi prej 25 € për studime të rregullta.

Pagesa bëhet në njëren prej bankave afariste me fletëpagesën, e cila shkarkohet dhe shtypet nga Ueb faqja Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

**I. UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ**  
Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë 134 studentë në fakultetet si në vijim:

| Programi  | Për studime të rregullta | Familja e dëshmorëve 2% | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12% | Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 3% | Kandidatët nga Shqipëria dhe Maqedonia 2% | Gjithsej |
|---|--------------------------|-------------------------|--|---|---|----------|
| Gjithsej  | 60                       | 8                       | 47                                       | 11  | 8   | 134      |
| Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit | 36                       | 3                       | 17                                       | 5   | 3   | 65       |
| Programi Arkitekturë i Interierit dhe Dizajni i Mobileve      | 0                        | 2                       | 10                                       | 3   | 2   | 18       |
| Programi: Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve të Drurit   | 36                       | 1                       | 7  | 2   | 1   | 47       |
| Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit                            | 0                        | 3                       | 18                                       | 4   | 3   | 28       |
| Programi Menaxhment i Turizmit dhe Hotelierisë                | 0                        | 3                       | 18                                       | 4   | 3   | 28       |
| Fakulteti i Inxhinierisë me Informatikë                       | 24                       | 2                       | 12                                       | 2   | 2   | 41       |
| Programi Inxhinieri Industriale me Informatikë                | 24                       | 2                       | 12                                       | 2   | 2   | 41       |

**PROVIMI PRANUES**

Provimi pranues për ata kandidatë që nuk kanë të kryer maturën mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të programeve të fakultetit dhe atë:

- Në Programin Arkitekturë e Interierit dhe Dizajni i Mobileve, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë
- Në Programin: Dizajni dhe konstruksionet e produkteve të drurit, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë
- Në Programin Menaxhment i Turizmit dhe Hotelierisë, nga lëndët: Ekonomi dhe ndërmarrësi, Matematikë, Informatikë
- Në Programin Inxhinieri Industriale me Informatikë, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë

Për kandidatët me maturë përzgjedhja do të bëhet sipas lëndëve prioritare dhe atë sipas programeve në vijim:

- Menaxhment i Turizmit dhe Hotelierisë**
  - Informatikë
  - Matematikë
  - Ekonomi dhe Ndërmarrësi
- Inxhinieri Industriale me Informatikë**
  - Matematikë
  - Informatikë
  - Fizikë
- Arkitekturë e Interierit dhe Dizajni i Mobileve**
  - Matematikë
  - Informatikë
  - Fizikë
- Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve të Drurit**

Lëndët prioritare

  - Matematikë
  - Informatikë
  - Fizikë
